



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË BERAT DHE NJËSIVE SHPENZUESE NË VARËSI, PËR MENAXHIMIN MIRËMBAJTËS TË GODINËS SË GJIMNAZIT "BABË DUDË KARBUNARA" DHE RUAJTJEN E AMBIENTEVE TË SAJ

Të nderuar këshilltarë!

Me fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025 sikundër jemi në dijeni në qytetin tonë hapi dyert për herë të parë për nxënësit edhe një prej projekteve më domethënës të ngritura në qytet, Gjimnazi "Babë Dudë Karbunara" në sajë të bashkëpunimit të Bashkisë Berat me Ministrinë e Arsimit dhe qeverisë shqiptare.

Theksojmë se kjo godinë ka një sipërfaqje totale prej 7500 m² (dyfishuar në krahasim me sipërfaqjen, që kishte më parë shkolla). Numri i nxënësve të shkollës është rritur nga 490-535 nxënës duke rritur kërkesat për menaxhimin mirëmbajtës të godinës. Ndërtesa në përbërjen funksionale të saj përmban 21 klasa, 12 kabinete, 1 palester, 1 bibliotekë, 8 njeje sanitare, zyra, ambjente teknike dhe ambjente të përbashkëta të hapura për komunitetin.

Shkolla është projektuar për të luajtur një rol multifunksional, përfshirë edhe rolin si Qendër Komunitare, mbështetur në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë edhe mundësinë e përdorimit të saj në çdo orë të ditës, njëkohësisht, në dispozicion të komunitetit në orare të ndryshme të ditës. Theksojmë gjithashtu se, godina është projektuar për të mos qenë e "rrethuar" me gardh apo mënyra të tjera të këtij lloji.

Godina, në zbatim të normave bashkëkohore të ndërtimit, është e pajisur me "Shkallët e Emergjencës", të cilat janë të ekspozuara dhe lehtësisht të aksesueshme nga çdokush,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

duke i mundësuar çdokujt të hyj edhe në ambientet e brendshme të shkollës, sepse dyert e emergjencës janë të tilla, që nuk duhet të kyçen.

Shkolla e mesme Babë Dudë Karbunara është ndërtuar me një infrastrukturë sa moderne aq edhe komplekse. Në çdo sistem të saj in ka nevojë për monitorim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Sistemi ngrohës është i përbërë nga kompleks kaldaje me 3 elementë që furnizojnë njeherësh gjithë shkollën me ngrohje qendore. Impianti ka infrastrukture të veçantë në mirëmbajtje pasi duhet vëzhgim i vazhdueshëm i procesit me qëllim, që e gjithë godina të ketë ngrohje efikase duke kursyer gjithashtu edhe lëndën djegëse.

Prandaj për të menaxhuar mirëmbajtjen e godinës, administrimin e kaldajës, ruajtjen e ambienteve të shkollës, nevojitet që të shtohen dy pozicione pune 1 (një) roje dhe 1 (një) mirëmbajtës kaldaje dhe godine të atashuara pranë Drejtorisë së Arsimit të Bashkisë Berat. Fondi i pagës për këta punonjës do të pasqyrohet në ndryshimet e Buxhetit të Bashkisë Berat 2024.

Për sa më sipër, kërkojmë miratimin tuaj për një shtesë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat dhe Njësisë Shpenzuese në varësi të saj, me 2 (punonjës), 1 (një) roje dhe 1 (një) mirëmbajtës kaldaje dhe godine.

Faleminderit,

N/KRYETARE E BASHKISË
ETLEVA DHIMA

DREJTOR I BURIMEVE NJERËZORË
GENTI DASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr _____ Datë ____ / ____ /2024

PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË BERAT DHE NJËSIVE SHPENZUESE NË VARËSI, PËR MENAXHIMIN MIRËMBAJTËS TË GODINËS SË GJIMNAZIT "BABË DUDË KARBUNARA" DHE RUAJTJEN E AMBIENTEVE TË SAJ

Këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës ____ . ____ .2024, pasi u njoh me materialin "Për një shtesë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat dhe Njësive Shpenzuese në varësi, për menaxhimin mirëmbajtës të godinës së Gjimnazit "Babë Dudë Karbunara" dhe ruajtjen e ambienteve të saj", mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1,1b, të Kreut III, neni 64 pikac, e Kreut X, ligjin 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Vendimin nr. 797, datë 20.12.2023 "Për miratimin e Strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat" për vitin 2024", VKB nr. 87, datë 18.12.2021 "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat dhe Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat", i ndryshuar dhe VKM-së, nr. 435, datë 26.06.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Të miratojë shtimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat dhe njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat me 2 (dy) punonjës, 1 roje dhe 1 mirëmbajtës kaldaje dhe godine qw do tw pozicionohen pranë Drejtorisë së Arsimit të Bashkisë Berat.
2. Fondi i pagës për kwta punonjws do të pasqyrohet në ndryshimet e Buxhetit të Bashkisë Berat 2024.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit pranw Bashkisw Berat, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca